



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.143

22 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9976
datë 8.9.2008

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin transnacional ERDF të bashkëpunimit territorial europian “Hapësira e Europës Juglindore”, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar, për vitin 2007” 6351

Ligj nr.9977
datë 8.9.2008

Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin e zhvillimit kufitar të qarkut të Kukësit, Shqipëri, për vitin 2007, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti II - bashkëpunimi ndërkufitar” 6357

Ligj nr.9978
datë 8.9.2008

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin për zhvillim” 6363

Ligj nr.9979
datë 8.9.2008

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, të përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave, për bashkëpunimin financiar” 6368

Ligj nr.9980 datë 8.9.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave”	6370
Ligj nr.9982 datë 8.9.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar	6378
Ligj nr.9983 datë 8.9.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar	6379
Ligj nr.9984 datë 11.9.2008	Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Komunitetit “Programi i veçantë për sipërmarrjen dhe novacionin (EIP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit, 2007-2013””.....	6380
Ligj nr.9985 datë 11.9.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar	6386
Ligj nr.9986 datë 11.9.2008	Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore	6387
Vendim i Kuvendit nr.211, datë 11.9.2008	Për zgjedhjen e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale	6389
Vendim i Kuvendit nr.212, datë 15.9.2008	Për shkarkimin e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, zotit Frano Kulli	6390

LIGJ
Nr.9976, datë 8.9.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN E FINANCIMIT TË PJESËMARRJES
SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN TRANSNACIONAL ERDF TË BASHKËPUNIMIT
TERRITORIAL EUROPIAN “HAPËSIRA E EUROPËS JUGLINDORE”, NËN
INSTRUMENTIN E NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA), KOMPONENTI I
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR, PËR VITIN 2007”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin transnacional ERDF, të bashkëpunimit territorial evropian “Hapësira e Europës Juglindore”, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar, për vitin 2007”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5880, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN E FINANCIMIT TË
PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN TRANSNACIONAL ERDF TË
BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN “HAPËSIRA E EUROPËS JUGLINDORE NËN
INSTRUMENTIN E NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA) KOMPONENTI II -
BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR, PËR VITIN 2007

datë
(Menaxhimi i centralizuar)

MARRËVESHJE FINANCIMI

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si “Palët”, ose individualisht si “Vendi përfitues” në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

duke pasur parasysh se:

a) Në 1 gusht 2006 Këshilli i Bashkimit European vendosi me anë të rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të ndihmës për paraaderimin (këtej e tutje: “Rregullorja kuadër IPA”). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet candidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet candidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t’u bërë një ditë, anëtare të Bashkimit European.

b) Në 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të Rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje: “Rregullorja e zbatimit IPA”).

c) Asistenca Komunitare, nën instrumentin e asistencës për paraaderim, duhet të vazhdojë të mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojnë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet potenciale candidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural.

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën instrumentin e paraaderimit.

e) Në datë 20 dhjetor 2007 Komisioni adaptoi programin operacional ERDF “Europa Juglindore”, me anë të vendimit C(2007) 6590.

f) Në datë 20 dhjetor 2007 Komisioni miratoi programin mbi financimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin ERDF “Hapësira e Europës Juglindore” (këtej e tutje “programi”). Ky program do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar.

g) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve, sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. Programi

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit 2007/019-464 (CRIS)

Titulli: Programi i financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin transnacional ERDF

të bashkëpunimit territorial europian “Hapësira e Europës Juglindore” nën komponentin IPA-bashkëpunimi ndërkufitar për vitin 2007.

2. Zbatimi i programit

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të datës 13 dhjetor 2006 (këtej e tutje: “Rregullorja Financiare”).

2. Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër mbi Rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet Palëve në 18 tetor 2007 (këtej e tutje: “Marrëveshja kuadër”), e cila ndodhet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. Strukturat dhe autoritetet përgjegjëse

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar të IPAS-s në përputhje me marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfaqësuesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së për paraaderim nën instrumentin IPA-s.

2. Koordinator kombëtar IPA do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendi përfitues në programet ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet e baseneve detare, nën instrumente të tjerë të komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e këtij programi. Kjo strukturë operuese duhet të bashkëpunojë me autoritetin menaxhues të programit transnacional Europa Juglindore dhe do të përfaqësohet në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit të këtij programi si anëtare me të drejta të plota.

4. Me shmangie nga pika 1 e aneksit të kësaj marrëveshjeje financimi, struktura operuese do të jetë Ministria e Integrimit Europian.

5. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës operuese përjashtojnë tenderimin, kontaktimin dhe pagesat, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Financimi

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i komunitetit për vitin 2007 për pjesëmarrjen në programin transnacional ERDF është përcaktuar në një maksimum prej 200,020 €, siç detajohet në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Deri në 10% të këtij kontributi të komunitetit mund të përdoret për të bashkëfinancuar kostot operacionale dhe administrative të shpenzuara nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi, siç detajohet në aneksin a të kësaj Marrëveshjeje.

5. Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale, të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje, do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara, siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. Afati për ekzekutimin e kontratave

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i ekzekutimit të kontratave mund të shtyhet para datës së përfundimit të tyre.

7. Afati i disbursimit

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data e fundit e zbatimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara, siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet para datës

së përfundimit të saj.

8. Trajtimi i fitimeve

1. Fitimet, në kuadër të IPA-s, përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose fatura të tjera ekuivalente, me përjashtim të:

a) fitimeve të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimit në firma;

b) fitimeve të nxjerra brenda kuadrit të një mase financiare teknike, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Fitimet siç përkufizohen në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme përkatëse për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionalisht, në varësi të fatit nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. Shpenzimet e lejueshme

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar, TVSH;

b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;

c) blerje, dhënie me qira ose me kredi e truallit dhe godinave ekzistuese;

d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;

e) kostot operacionale;

f) pajisje të dorës së dytë;

g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;

h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;

i) kontribute në natyrë;

j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

a) taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre;

ii) është përcaktuar që ato të mbulohen nga përfituesi i fundit; dhe

iii) janë të identifikuara qartë në projektpropozim.

b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;

c) në rast se zbatimi i një aksioni kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;

d) kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aksionin e bashkëfinanciar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;

e) kostot e garancisë të siguruara nga një bankë ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit;

f) shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkte të një aktiviteti, i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Për llogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht;

g) blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të Rregullores së Zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritete publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme.

a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm

nga përfituesi i fundit gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti.

b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht ose direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'i ngarkojnë kostot e referuar në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve të fundit, ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë ose kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

Kostot e referuara në pikën b të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë veprim.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregullat e mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin transnacionale ERDF.

10. Ruajtja e dokumenteve

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. Plani për decentralizimin pa kontrolle *ex-ante*

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa treguese dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex-ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan tregues për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1, dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. Interpretimi

1. Në rastet kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të mbajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastet kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, referencat duhet t'i bëhen Marrëveshjes së ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të transpozohen në këtë Marrëveshje me anë të amendimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

13. Pavlefshmëria e pjesshme dhe të metat e paqëllimshme

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban të meta të paqëllimta, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të plotësojnë çdo të metë të paqëllimtë nëpërmjet një dispozite, e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. Rishikimi dhe amendimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekti i rishikimeve periodike në kohë, të rëna dakord ndërmjet Palëve.

2. Çdo amendim për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Amendime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet Palëve.

15. Përfundimi

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë duke informuar me shkrim Palën tjetër. Ky përfundim hyn në veprim gjashtë muaj kalendarik, që nga data e njoftimit me shkrim.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit mes Palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila nga Palët mund ta çojë çështjen për gjykim në arbitrazh në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme për Arbitrazh që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet, të cilat janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë anglishtja. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga cilado nga Palët. Vendimi i arbitrit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelles.

17. Njoftime

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për komunitetin:

z.Helmuth Lohan

Shef i delegacionit

Delegacioni i Komisionit Europian në Shqipëri

Rruga e Durrësit 127-1

Laparakë-Tiranë

Fax: +355 4230752

Për vendin përfitues

znj.Majlinda Bregu

Ministre e Integritetit

Rruga: "Lek Dukagjini", nr.3

P.O.Boxh 8302

Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 4256267

18. Gjuha

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. Shtojcat

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e dytë.

Firmosur dhe në emër të Komisionit

Z.Helmuth Lohan

Shef i Delegacionit të Komisionit Europian

Tiranë

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të

Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga

znj.Majlinda Bregu

Ministre e Integritetit

Tiranë

ANEKSI A. Programi i financimit për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin transnacional ERDF të bashkëpunimit territorial europian "Hapësira e Europës Juglindore" nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar të instrumentit IPA për vitin 2007, aprovuar me vendimin e Komisionit C (2007) 6428.

ANEKSI B. Marrëveshja kuadër ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 18 tetor 2007.

ANEKSI C. Raportimi

1. Struktura operuese përgjegjëse për pjesëmarrjen e vendit përfitues në programin(et)

transnacionale (e) duhet t'i dërgojë Komisionit dhe Koordinatorit Kombëtar të IPA-s një raport vjetor dhe një raport final mbi zbatimin e këtij programi.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason adaptimin e programit ndërkufitar.

Raporti final duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) progresin e bërë gjatë pjesëmarrjes në programin(et) transnacionale(e) dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike të verifikueshme, me një përcaktim sasior të tyre, kudo dhe kurdo që kjo të jetë e mundur;

b) hapat e ndërmarra nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave;

- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo masë të marrë;

- përdorimin e asistencës teknike;

c) masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat a deri në c të këtij paragrafi mund të jepen në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën b të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

LIGJ

Nr.9977, datë 8.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT KUFITAR TË QARKUT TË KUKËSIT, SHQIPËRI, PËR VITIN 2007, NËN INSTRUMENTIN E NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA), KOMPONENTI II - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin e zhvillimit kufitar të qarkut të Kukësit, Shqipëri, për vitin 2007, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti II - bashkëpunimi ndërkufitar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5881, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN E ZHVILLIMIT**

KUFITAR TË QARKUT TË KUKËSIT, SHQIPËRI, PËR VITIN 2007 NËN INSTRUMENTIN E
NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA) KOMPONENTI II-BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR

datë
(Menaxhimi i centralizuar)

MARRËVESHJE FINANCIMI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si “Palët” ose individualisht si “Vendi përfitues”, në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

duke pasur parasysh se:

a) Në 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit European vendosi me anë të rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të ndihmës për paraaderimin (këtej e tutje: “Rregullorja kuadër IPA”). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet kandidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet kandidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara), në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t’u bërë një ditë, anëtare të Bashkimit European.

b) Në 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të Rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje: “Rregullorja e zbatimit IPA”).

c) Asistenca e komunitetit nën instrumentin e asistencës për paraaderim duhet të vazhdojë të mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojnë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural.

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës së komunitetit nën instrumentin e paraaderimit.

e) Në datën 20 dhjetor 2007, Komisioni miratoi programin mbi zhvillimin kufitar të qarkut shqiptar të Kukësit nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar të instrumentit IPA për Shqipërinë për vitin 2007 (këtej e tutje: “Programi”). Ky program do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar.

f) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve, sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë.

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. Programi

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit 2007/019-324 (CRIS)

Titulli: Programi i zhvillimit kufitar të qarkut shqiptar të Kukësit nën komponentin IPA-bashkëpunimi ndërkufitar për vitin 2007.

2. Zbatimi i programit

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të

datës 13 dhjetor 2006 (këtej e tutje: “Rregullorja financiare”).

2. Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes kuadër mbi rregullat për bashkëpunimin, që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të instrumentit të paraaderimit (IPA), të arritur ndërmjet Palëve në 18 tetor 2007 (këtej e tutje: “Marrëveshja kuadër”), e cila ndodhet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. Strukturat dhe autoritetet përgjegjëse

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA në përputhje me Marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfaqësuesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit, si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së për paraaderim nën instrumentin IPA-s.

2. Koordinator kombëtar IPA do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese përgjegjëse për zbatimin e këtij programi, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Financimi

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i komunitetit për vitin 2007, për pjesëmarrjen në programin, është përcaktuar në një maksimum prej 500 000 €, siç detajohet në program. Megjithatë, pagesa e kontributit të komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostot e strukturave dhe autoriteteve të ngritura nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi duhet të përballohen nga përfituesi, me përjashtim të kostove të referuara në nenin 94(1f) të rregullores së implementimit IPA.

5. Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale, të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje, do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara, siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij, për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. Afati për ekzekutimin e kontratave

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetëve që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara, siç duhet, afati përfundimtar i ekzekutimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. Afati i disbursimit

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data e fundit e zbatimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara, siç duhet, afati për disburimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të saj.

8. Trajtimi i fitimeve

1. Fitimet, në kuadër të IPA-s, përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose fatura të tjera ekuivalente, me përjashtim të:

a) fitimeve të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimit në firma;

b) fitimeve të nxjerra brenda kuadrit të një mase teknike financiare, duke përfshirë kapitalin me sipërmarrje të përbashkët dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Fitimet, siç përkufizohen në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e

programit këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme përkatëse për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionalisht, në varësi të faktit nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. Shpenzimet e lejueshme

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

- a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar, TVSH;
- b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;
- c) blerje, dhënie me qira ose me kredi e truallit dhe godinave ekzistuese;
- d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- e) kostot operacionale;
- f) pajisje të dorës së dytë;

g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;

h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;

i) kontribute në natyrë;

j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

a) taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre;

ii) është përcaktuar që ato mbulohen nga përfituesi i fundit; dhe

iii) janë të identifikuar qartë në projektpropozim;

b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;

c) në rast se zbatimi i një aksioni kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;

d) kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me operacionin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;

e) kostot e garancisë të siguruar nga një bankë ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i komunitetit;

f) shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkte të një aktiviteti, i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Për llogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht;

g) blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.

4. Përveç asistencës teknike për programin e zhvillimit kufitar, referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritetet publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti, do të jenë të lejueshme:

a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik, që është i ndryshëm nga përfituesi final gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti;

b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë, nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht ose direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'i ngarkojnë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve të fundit, ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë ose kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

Kostot e referuara në pikën b të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuar me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë veprim.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregullat e mëtejshme mbi shpenzimet e

lejueshme mund të përcaktohen në programin transnacional ERDF.

10. Ruajtja e dokumenteve

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. Plani për decentralizimin pa kontrolle *ex-ante*

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa treguese dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex-ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan tregues për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1 dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. Interpretimi

1. Në rastet kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të mbajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastet kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, referencat duhet t'i bëhen Marrëveshjes së ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të transpozohen në këtë Marrëveshje me anë të amendimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

13. Pavlefshmëria e pjesshme dhe të metat e paqëllimshme

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban të meta të paqëllimta, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo të metë të paqëllimtë nëpërmjet një dispozite, e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. Rishikimi dhe amendimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord ndërmjet Palëve.

2. Çdo amendim, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve, do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Amendime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet Palëve.

15. Përfundimi

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë duke informuar me shkrim Palën tjetër. Ky përfundim hyn në veprim gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit mes Palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila nga Palët mund ta çojë çështjen për gjykim në

arbitrazh në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme për Arbitrazh që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet, të cilat janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë anglishtja. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga cilado nga Palët. Vendimi i arbitrit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha Palët dhe nuk do të ketë proces ankimi.

17. Njoftime

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për komunitetin
z.Helmuth Lohan
Shef i delegacionit
Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri
Rruga e Durrësit 127-1
Laparakë-Tiranë
Fax: +355 4230752

Për vendin përfitues:
znj.Majlinda Bregu
Ministre e Integritetit
Rruga "Lek Dukagjini", nr.3
P.O.Box 8302
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4256267

18. Gjuha

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. Shtojcat

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e dytë.

Firmosur dhe në emër të Komisionit

z.Helmuth Lohan
Shef i delegacionit të Komisionit European
Tiranë
Datë

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga
znj.Majlinda Bregu
Ministre e Integritetit
Tiranë
Datë

SHTOJCA A. Programi i zhvillimit kufitar të qarkut shqiptar të Kukësit nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar të instrumentit IPA, për Shqipërinë, për vitin 2007, aprovuar me vendimin e Komisionit C (2007) 6428.

SHTOJCA B. Marrëveshja kuadër ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 18 tetor 2007.

SHTOJCA C. Raportimi

1. Struktura operuese përgjegjëse për pjesëmarrjen e në programin e zhvillimit kufitar duhet t'i dërgojë Komisionit dhe koordinatorit kombëtar IPA-s një raport vjetor dhe një raport final mbi zbatimin e këtij programi.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason miratimin e programit ndërkufitar.

Raporti final duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) progresin e bërë gjatë implementimit të programit të zhvillimit kufitar dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike të verifikueshme, me një përcaktim sasior të tyre, kudo dhe kurdo që kjo të jetë e mundur, duke përdorur treguesit referuar nenit 94 (1) (d) të rregullores së implementimit IPA në nivel aksi prioritar;

b) hapat e ndërmarrë nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e

zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave;
- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;

- përdorimin e asistencës teknike;

- c) masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat “a” deri në “c” të këtij paragrafi mund të jepet në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën “b” të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

LIGJ

Nr.9978, datë 8.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin për zhvillim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5882, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË MBI BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, më poshtë përmendur si “Pala shqiptare” dhe Qeveria e Republikës së Austrisë, më poshtë përmendur si “Pala austriake”,

- *duke pasur* si qëllim forcimin e lidhjes së miqësisë ndërmjet të dy vendeve;

- *me dëshirën* për t’i fuqizuar këto marrëdhënie përmes zhvillimit, shtrirjes dhe thellimit të bashkëpunimit të tyre për zhvillim;

- *duke synuar* që të kontribuojnë për një rritje ekonomike dhe një zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë nga ana shoqërore, si edhe drejt reformave politike, ekonomike e shoqërore të nevojshme që Shqipëria t’i përshtatet gjithnjë e më shumë strukturave të BE-së; dhe

- *duke synuar* që të kontribuojnë në qëllimet e përgjithshme të bashkëpunimit austriak për zhvillim, siç parashikohen në ligjin e bashkëpunimit për zhvillim të vitit 2002, të tilla si ulja e varfërisë, ruajtja e paqes dhe sigurisë njerëzore, si edhe ruajtja e mjedisit;

- *duke ripohuar* përkushtimin e tyre për të nxitur vlerat dhe standardet europiane për gjatë gjithë bashkëpunimit të tyre, siç bëhet referim në kriteret për anëtarësimin në BE, të përshkruara nga Këshilli European i Kopenhagës i vitit 1993, demokracia, sundimi i ligjit, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe respektimi i pakicave, një ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për t’iu përshtatur *acquis communautaire*,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje përcakton afatet dhe kushtet e përgjithshme për bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë të financuara mbi bazë grantesh dhe të emëruara si ndihmë zyrtare për zhvillim.

Neni 2

Synimet dhe parimet e bashkëpunimit

Të dyja Palët do të nxisin, brenda kuadrit të legjislacioneve përkatëse të brendshme të tyre, programe dhe projekte për bashkëpunimin e përbashkët për zhvillim.

Të dyja Palët do të bazojnë bashkëpunimin e tyre në zotimet e Deklaratës së Parisit mbi efektshmërinë e ndihmës dhe do të ndërmarrin veprime në drejtim të realizimit të parimeve të zotërimit, grupimit, harmonizimit, drejtimit, me synim rezultatet dhe besueshmërisë së ndërsjellë.

Të dyja Palët do të përpiqen të vënë në lëvizje maksimumin e burimeve për të bashkëfinancuar programe dhe projekte të përbashkëta për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. Si parim, ortakët nga të dy vendet do të kontribuojnë me burimet e tyre për vënien në jetë të çdo programi dhe projekti.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi për zhvillim mund të jetë në formën e bashkëpunimit teknik apo financiar, të ndihmesës humanitare apo asaj për raste emergjencash. Ai mund të kryhet mbi baza krejtësisht dypalëshe apo gjithashtu në bashkëpunim me donatorë të tjerë dhe/ose organizata shumëpalëshe.

Neni 4

Delegimi i pushteteve, dialogu mbi politikat

Të dyja Palët do të përfaqësojnë qeveritë e tyre përkatëse në çështjet që lidhen me vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Përfaqësues të të dyja Palëve do të takohen rregullisht, me qëllim që të përcaktojnë përparësi të përbashkëta dhe parime të bashkëpunimit, të japin udhëzime për vënien në jetë të programeve dhe projekteve të ardhshme të bashkëpunimit për zhvillim, të përfshihen në dialogun mbi politikat dhe të vlerësojnë përparimin e programeve. Përfundimet e çdo takimi do të regjistrohen me shkrim dhe do të nënshkruhen nga përfaqësuesit e të dyja Palëve.

Neni 5

Dispozita të përgjithshme mbi përjashtimet nga taksat dhe tarifat doganore

Me qëllim që të lehtësohet vënia në jetë e çfarëdo projekti sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala shqiptare:

- do të përjashtojë të gjitha mallrat, përfshirë këtu pajisjet dhe materialet, punimet dhe shërbimet, e siguruara apo të financuara, mbi bazën e një granti nga Austria, nga taksat, detyrimet doganore, detyrimet fiskale (përfshirë këtu TVSH) dhe detyrime të tjera;

- do të japë të gjitha lejet, autorizimet, licencat, miratimet ose çdo dokument të ngjashëm që është i nevojshëm për importin (përfshirë këtu importin e përkohshëm) dhe rieksporimin e pajisjeve të kërkuara për vënien në jetë të projekteve.

Neni 6

Kushtet për institucionet, OJQ-të dhe shoqëritë e vendeve të tjera

Kur institucione, organizata joqeveritare, shoqëri apo persona të tjerë juridikë nga vende të ndryshme nga Shqipëria kontraktohen nga Austria për të kryer detyra në Shqipëri brenda kuadrit të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet Austrisë dhe Shqipërisë, sa vijon do të zbatohet në Shqipëri.

Persona të tillë juridikë nuk do të mbajnë përgjegjësi për mosarritjen e plotësimit të atyre që kishin marrë përsipër, nëse kjo u detyrohet udhëzimeve apo rekomandimeve në lidhje me sigurinë, të lëshuara nga Pala austriake.

Ata do të kenë të drejtën të importojnë dhe rieksporojnë, të përjashtuar nga detyrimet doganore dhe detyrime të tjera të ngjashme, pajisje profesionale dhe mallra që atyre u nevojiten për të përmbushur ato që kanë marrë përsipër, apo t'i shesin të tilla pajisje brenda Shqipërisë, pas pagimit të detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera të ngjashme, kur këto nuk janë më të nevojshme për të siguruar shërbimet e tyre.

Ato do të përjashtohen nga taksat dhe taksime të tjera të ngjashme mbi përfitimet e shoqërive, mbi bazën e xhiros apo çdo bazë tjetër të ngjashme, dhe mbi pagesat apo shpërblimet që u paguhen atyre nga Austria për shërbimet e tyre brenda kuadrit të projekteve/programeve të bashkëpunimit për zhvillim.

Ato do të kenë të drejtën të hapin llogari bankare në vende të tjera dhe t'i vënë ato në veprim për përmbushjen e atyre që kanë marrë përsipër. Mbajtja me efikasitet e llogarive nuk do të pengohet nga kontrollet mbi shkëmbimet financiare të huaja apo detyrime të vëna nga Shqipëria dhe balanca në këto llogari të huaja do të jetë lehtësisht e transferueshme në çfarëdo monedhë të shkëmbyeshme.

Ato do të përjashtohen nga të gjitha detyrimet për t'u regjistruar në Shqipëri për autorizime të natyrës profesionale, taksa apo arsye të tjera, dhe nuk do të kenë asnjë detyrim për t'u paraqitur informacion autoriteteve të taksave të Shqipërisë, përveçse kur ato kryejnë veprimtari biznesi në Shqipëri, të cilat nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

Neni 7

Kushtet e personelit nga vende të tjera

Kushtet në vijim do të zbatohen në Shqipëri ndaj personave fizikë që nuk janë banues të përhershëm në Shqipëri, përfshirë këtu edhe qytetarët e Shqipërisë të cilët:

a) po kryejnë detyra në Shqipëri brenda kuadrit të programeve/projekteve të bashkëpunimit për zhvillim të financuara nga Austria; me kusht që ato apo punëdhënësi i tyre të ketë një kontratë me Austrinë;

b) janë bashkëshortë, bashkëbanues apo persona në varësi të personave pjesë e personelit të përmendur në pikën (a) më lart.

Ligjet e Shqipërisë do të zbatohen për këtë personel të referuar në pikat (a) dhe (b) të paragrafit të mësipërm, përveçse kur është rënë dakord ndryshe në këtë Marrëveshje apo në marrëveshje të tjera ndërmjet palëve.

Pala shqiptare do ta garantojë personelin referuar në pikat (a) dhe (b) të paragrafit të parë të këtij neni, për sa vijon:

a) miratimin dhe lëshimin e shpejtë, pa pagesë, me shumë hyrje-dalje, të vizave për të rihyre dhe dalë për gjatë gjithë kohës së detyrës së tyre;

b) lëvizjen e lirë brenda vendit dhe të drejtën për të hyrë dhe për t'u larguar nga vendi në shtrirjen e nevojshme për vënien në jetë të programit/projektit;

c) lëshimin e shpejtë të të gjitha lejeve apo licencave, të tilla si leje qëndrimi, leje pune, leje kërkimore dhe leje profesionale, si edhe përjashtimin nga kufizimet mbi migrimin dhe regjistrimin e të huajve gjatë periudhës që ato janë të mbuluar nga kjo Marrëveshje.

d) lehtësi të njëjta riatdhesimi si për personelin e misioneve diplomatike, në raste krizash të brendshme apo ndërkombëtare.

Pala shqiptare do ta garantojë personelin për sa vijon:

a) përjashtimin nga taksa mbi të ardhurat vetjake dhe çdo taksë tjetër e drejtpërdrejtë në lidhje

me pagat që u paguhen atyre nga Austria ose nga një punëdhënës që ka marrë përsipër të kryejë shërbime apo të shpërndajë mallra në një kontratë me Austrinë apo Shqipërinë drejtpërdrejt apo si nënkontraktues;

b) të drejtën për të importuar dhe rieksportuar, të përjashtuar nga detyrimet doganore apo detyrime të tjera, pajisje profesionale dhe mallra që i nevojiten personelit për të kryer detyrën e tyre.

Personelit që shërben për më shumë se gjashtë muaj do t'i garantohet edhe sa vijon:

a) e drejta për ta hapur dhe vënë në veprim një llogari të jashtme bankare në Shqipëri për nevojat e tyre vetjake, llogari të tilla do të jenë të përjashtuara nga çdo kontroll mbi shkëmbimet financiare apo detyrime të vëna nga Shqipëria dhe balancat do të jenë lehtësisht të transferueshme në çfarëdo monedhe tjetër të shkëmbyeshme;

b) përjashtimi nga detyrimet mbi importin dhe eksportin, tarifatat doganore dhe detyrime të tjera, pagesa, taksime apo çfarëdo detyrimesh të tjera përfshirë këtu edhe TVSH, mbi sendet vetjake dhe shtëpiake, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në pajisjet shtëpiake, sendet vetjake dhe automjetet. Sendet e importuara në këtë mënyrë mund t'u shiten personave të tjerë të cilët edhe ata gëzojnë përjashtime. Nëse sendet e importuara në këtë mënyrë disponohen ndryshe, për to të paguhen detyrimet dhe/ose pagesat e përshtatshme.

Shqipëria mund të kërkojë largimin apo zëvendësimin e cilitdo pjesëtar të personelit të vënë në dispozicion nga Austria, puna apo sjellja e të cilit vlerësohet e pakënaqshme. Austria mund të largojë cilindo pjesëtar të personelit të saj.

Neni 8 Zbatimi

Për Palën austriake, përgjegjësia për vënien në jetë të programit austriak për bashkëpunimin për zhvillim të Ministrisë Austriake të Punëve të Jashtme, bie mbi Agjencinë Austriake të Zhvillimit. Bashkërendimi i projekteve do të sigurohet nga përfaqësuesi i bashkëpunimit austriak për zhvillim në Tiranë. Për Palën shqiptare, bashkërendimi i projekteve do të sigurohet nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj. Ato do të informojnë rregullisht njëri-tjetrin mbi përparimin e bërë në lidhje me vënien në jetë të projekteve të marra përsipër sipas kësaj Marrëveshjeje.

Secili projekt, sipas qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, do t'i nënshtrohet një kontrate të posaçme ndërmjet partnerëve të veçantë të projektit, duke përcaktuar me hollësi të drejtat dhe detyrimet që i lindin çdo partneri të projektit.

Rregullat dhe procedurat e zbatueshme për blerjen e shërbimeve, mallrave dhe punimeve do të përcaktohen në kontratat që do të rregullojnë programet/projektet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9 Klauzola kundër korrupsionit

Të dyja Palët kanë si shqetësim të përbashkët luftën kundër korrupsionit, ç'ka vë në rrezik qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve të nevojshme për zhvillim e për më tepër rrezikon konkurrimin e lirë e të hapur të bazuar mbi çmimin dhe cilësinë. Si rrjedhim, ato deklarojnë qëllimin e tyre për të kombinuar përpjekjet e tyre për të luftuar korrupsionin dhe deklarojnë në veçanti se asnjë ofertë, dhuratë, pagesë, konsideratë apo përfitim i çfarëdo lloji, i cili përbën një veprim të paligjshëm apo praktikë korruptive, as nuk është bërë e as nuk do të bëhet drejtpërdrejt apo tërthorazi si një shtysë apo shpërblim për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Çfarëdo veprimi i këtij lloji përbën një bazë të mjaftueshme për ta përfunduar këtë Marrëveshje apo për të ndërmarrë çfarëdo mase tjetër shtrënguese të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, përkatës i palëve.

Neni 10 Shtesa, interpretime

Çfarëdo shtese ndaj kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim. Çfarëdo shtesë e tillë do të hyjë në fuqi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 11.

Çfarëdo konflikti në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet

miqësisht përmes kanaleve diplomatike.

Neni 11

Hyrja në fuqi, përfundimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason muajin në të cilin të dy Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme në vendet e tyre përkatëse. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të mbulojë të gjitha projektet në vazhdim dhe projekte që janë duke u përgatitur, përveçse kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen përkatëse të projektit.

Marrëveshja mund të përfundojë me shkrim nga cilado Palë në çdo kohë. Përfundimi do të ketë fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas njoftimit përmes kanaleve diplomatike. Ai nuk do të prekë programet dhe projektet në vazhdim në kohën e njoftimit të përfundimit.

Bërë në dy kopje të njëjta, secila prej tyre në gjuhën shqipe, gjermane dhe angleze. Në raste mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Tiranë më 3.6.2008

LIGJ

Nr.9979, datë 8.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA FEDERALE E FINANCIVE, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, të përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave, për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5883, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I FINANCave DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
AUSTRIËSË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI FEDERAL I FINANCave MBI BASHKËPUNIMIN
FINANCIAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, dhe Qeveria e Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, këtu të quajtura “Palët Kontraktuese”,

- me dëshirën për të nxitur më tej marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve të tyre;

- me dëshirën për të zhvilluar, zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin e suksesshëm në fushën financiare,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Palët Kontraktuese përpiqen në kuadrin e ligjeve, rregulloreve dhe politikave të tyre përkatëse në fuqi, si dhe të detyrimeve të tyre ndërkombëtare të nxisin dhe zgjerojnë bashkëpunimin financiar.

Neni 2

Për qëllimin e nxitjes dhe zgjerimit të bashkëpunimit financiar, Ministri Federal Austriak i Financave është i gatshëm të mbështesë dhënien e kredive të ndihmës me terma koncesionare, të rifinancuara nga Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft (OeKB), Vjenë, në bazë të skemës së saj financiare të eksportit.

Një kuadër tregues financiar deri në 25 000 000 euro (njëzet e pesë milionë euro) parashikohet mbi një bazë përjashtimore për një periudhë deri në dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Termat dhe kushtet e huave do të caktohen në pajtim me detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga “Masa për kreditë e eksportit të mbështetura zyrtarisht” nën kujdesin e OECD-së. Kështu, niveli i koncesionit do të jetë të paktën 35%.

Përshtatshmëria e projekteve që duhet të financohen do të vlerësohen duke marrë parasysh udhëzuesin *ex-ante* në bazë të disiplinave përkatëse të ndihmave “Helsinki”, si dhe të kriterëve të zbatueshme të brendshme të alokimit.

Neni 4

Marrëveshjet e huasë të rifinancuara nga OeKB-ja negocohen drejtpërdrejt ndërmjet bankave tregtare si huadhënës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Neni 5

Përfshirja e projekteve në këtë Marrëveshje do të miratohet nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale të Financave të Republikës së Austrisë. Ajo bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme gjatë periudhës 24-mujore, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Projektet në negociim e sipër para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje mund të përfshihen.

Neni 6

Huatë e dhëna duhet të përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve austriake që mund të përbëjnë deri në 30% të mallrave dhe shërbimeve me origjinë jashtë Austrisë.

Neni 7

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, garanton në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushte përmbushjen e të gjitha pagesave që rrjedhin nga huatë koncesionare austriake të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga imuniteti ndaj padisë apo ekzekutimit për të cilin mund të ketë të drejtë në lidhje me pagesat e garantuara nga kjo Marrëveshje.

Neni 8

Të gjitha pagesat në lidhje me huatë koncesionare përjashtohen nga të gjitha taksat dhe tarifat që caktohen nga Pala shqiptare.

Neni 9

Palët Kontraktuese në një bazë vjetore ose kurdoherë që mendohet e nevojshme nga Palët Kontraktuese rishikojnë progresin e bërë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Me qëllim që të vlerësohet përdorimi i huave të koncesionit të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe qëndrueshmëria e projekteve përkatëse, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë lehtëson nxjerrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin, auditimin dhe monitorimin e projekteve.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me pajtim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në ditën e parë të muajit pas muajit në të cilin Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën mbi përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme në vendin e tyre përkatës. Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë dyvjeçare.

Bërë në dy kopje origjinale, të dyja në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9980, datë 8.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË QIPROS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5884, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË QIPROS MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Qipros, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”,

- *me dëshirën* për të nxitur bashkëpunimin në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor ndërmjet vendeve të tyre dhe në transitit përmes territoreve të tyre;
 - *të frymëzuara* nga parimi i liberalizimit në lidhje me transportin rrugor;
 - bazuar në parimin e reciprocitetit dhe interesit të përbashkët;
- kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për:

1. transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese dhe në transitit përmes tyre;
2. udhëtimin e mjeteve bosh në lidhje me transportin e përmendur më sipër.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “transportues” nënkupton një person fizik ose juridik të vendosur në territorin e njërës Palë Kontraktuese, i cili ka të drejtë të kryejë transportin rrugor të udhëtarëve ose mallrave në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendin e tij.

2. Termi “mjet” nënkupton:

a) për transportin e mallrave, një automjet ose kombinim mjeteve nga të cilët të paktën mjeti motorik është i regjistruar në territorin e njërës Palë Kontraktuese dhe i cili përdoret dhe pajiset vetëm për transportin e mallrave.

b) për transportin e udhëtarëve, cilido mjet motorik i regjistruar në territorin e njërës Palë Kontraktuese, i cili në bazë të ndërtimit dhe pajisjeve të tij, është i përshtatshëm për transportin e më shumë se nëntë personave, përfshirë shoferin.

3. Termi “transit” nënkupton transportin e mallrave ose udhëtarëve nga një transportues i një Palë Kontraktuese përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Në rastin e Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Në rastin e Republikës së Qipros:

Ministria e Komunikacioneve dhe Punëve.

2. Në rast se ndonjë prej autoriteteve kompetente të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni ndryshohet, emri i autoritetit të ri i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike.

I. Transporti i udhëtarëve

A. Qëllimi dhe përkufizimet

Neni 4

Zbatimi

Për qëllime të transportit të udhëtarëve, kjo Marrëveshje zbatohet:

1. Për të gjitha shërbimet e transportit të udhëtarëve me qira ose shpërblim ose për llogari të vet me mjete për udhëtarë (autobus), ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese dhe në transit përmes tyre.

Termi “shërbimet e transportit të udhëtarëve për llogari të vet” nënkupton operacionet që kryhen nga një sipërmarrje për punonjësit e saj ose nga një organizëm jofitimprurëse për transportin e anëtarëve të tij në lidhje me objektivat socialë të tij, me kusht që:

- aktiviteti i transportit të jetë vetëm një aktivitet ndihmës për sipërmarrjen ose organizimin;
- mjetet e përdorura të jenë pronë e asaj sipërmarrjeje ose organizmi, ose që kanë qenë siguruar për periudha të shtyra nga ata, ose kanë qenë subjekt i një kontrate qiraje afatgjatë dhe drejtohen nga një anëtar i stafit të sipërmarrjes ose organizmit.

2. Për udhëtimet pa ngarkesë të mjeteve në lidhje me këto shërbime.

Neni 5

Përkufizime

Për qëllime të transportit të udhëtarëve:

1. “Shërbime të rregullta” nënkupton shërbimet të cilat mbështesin transportin e udhëtarëve sipas një frekuence të veçantë dhe përgjatë itinerarëve të caktuar, përmes së cilave udhëtarët mund të hipin ose të zbresin në stacione të paracaktuar. Shërbimet e rregullta mund t’i nënshtrohen detyrimit të respektimit të orareve dhe tarifave të vendosura më parë.

2. “Shërbime vajtje-ardhje” nënkupton shërbimet përmes të cilave, me anë të udhëtimeve të përsëritura në vajtje dhe në kthim, grupet e udhëtarëve të formuar më parë transportohen nga një vend i veçantë i nisjes drejt një vendi të veçantë të destinacionit, të vendosur përkatësisht në territoret e Palëve Kontraktuese. Çdo grup i përbërë nga udhëtarë, të cilët kryejnë udhëtime në vajtje, kthehen në vendin e nisjes me një udhëtim të mëpasëm.

a) Gjatë shërbimeve vajtje-ardhje, asnjë udhëtar nuk hipën ose zbret gjatë udhëtimit.

b) Udhëtimi i parë në kthim dhe i fundit në vajtje në një seri udhëtimesh vajtje-ardhje do të kryhen pa ngarkesë.

c) Shërbime të rregullta dhe vajtje-ardhje dhe kushtet në lidhje me operacionet e tyre përcaktohen në bazë të një marrëveshjeje të përbashkët të autoriteteve kompetente të arritur ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bazë të përfundimeve të miratuara nga komiteti i përbashkët, i cili krijohet sipas nenit 15.

3. “Transit” nënkupton transportin e udhëtarëve që fillon te territori i Palës Kontraktuese, ku mjete është i regjistruar, kalon përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese dhe e kundërta, me kusht që asnjë udhëtar nuk hipën ose zbret.

4. “Shërbimet e rastit” janë:

a) udhëtimet me dyer të mbyllura, domethënë shërbimet përmes të cilave i njëjti mjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë gjithë udhëtimit dhe i kthen ata përsëri në vendin e nisjes, i cili është vendi ku mjeti është i regjistruar;

b) shërbimet të cilat e bëjnë udhëtimin në vajtje me ngarkesë dhe udhëtimin në kthim pa ngarkesë;

c) shërbimet të cilat e bëjnë udhëtimin në vajtje pa ngarkesë dhe udhëtimin në kthim me ngarkesë, me udhëtarë të hipur në të njëjtën pikë të vendit, ku mjeti nuk është i regjistruar, me kusht që udhëtarët:

i) të përbëjnë një grup të formuar më parë sipas një kontrate të transportit të përfunduar para mbërritjes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese ku ata kanë hipur, ose

ii) të jenë sjellë më parë nga i njëjti transportues sipas kushteve të specifikuara në paragrafin 2, b dhe me kusht që ata të hipin përsëri dhe të transportohen në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit; ose

iii) të jenë ftuar në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit, kosto e transportit përballohet nga personi që dërgon ftesën.

B. Hyrja në treg

Neni 6

Shërbimet e rregullta dhe të rastit

1. Shërbimet e rastit të përmendura në nenin 5, paragrafi 4.a, përjashtohen nga nevoja për autorizim transporti në territorin e Palës Kontraktuese ku mjeti nuk është i regjistruar:

2. Shërbimet e rastit kryhen në bazë të një dokumenti të kontrollit;

3. dokumenti i kontrollit përbëhet nga një formular udhëtimi.

4. Formulari i udhëtimit përmban të paktën informacionin që vijon:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin kryesor;

c) transportuesin (it) e përfshirë;

d) listën e plotë të udhëtarëve.

5. Librat e formularëve të udhëtimit jepen nga autoritete kompetente të Palës Kontraktuese ku mjeti është i regjistruar ose organizmat e caktuar nga ky autoritet.

6. Shërbimet e rastit të përmendura në nenin 5, paragrafët 4.b dhe 4.c mund të operohen vetëm në bazë të autorizimeve të mjaftueshme. Numri dhe lloji i autorizimeve të tilla duhet të përcaktohen bashkërisht nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese gjatë takimeve të Komitetit të Përbashkët të krijuar sipas nenit 15.

Për rastin e paragrafit 4.c (i) të nenit 5, kërkohet gjithashtu një kopje e kontratës së transportit.

Për rastin e paragrafit 4.c (ii) të nenit 5, kërkohet dokumenti që shoqëron mjetin gjatë udhëtimit në vajtje me ngarkesë dhe udhëtimit në kthim pa ngarkesë.

7. Shërbimet e rregullta në transportin transit kryhen me autorizime të lëshuara nga vendi i transimit pas dorëzimit të një kërkesë me shkrim me të gjitha dokumentet e nevojshme, nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese që ka lëshuar autorizimin për shërbimet e rregullta. Vlefshmëria e tij zgjat nga një deri në tre vjet dhe jepet falas.

8. Gjatë transportit transit udhëtarët nuk mund të hipen ose të zbriten gjatë udhëtimit, vetëm po të vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përmes Komitetit të Përbashkët.

9. Nuk kërkohet autorizim për zëvendësimin e një mjeti të prishur, gjithashtu edhe për udhëtimet e mjeteve pa ngarkesë të cilët kryejnë transport siç përmendet në nenin 4.

10. Transporti i udhëtarëve për llogari të vet i nënshtrohet autorizimit që lëshohet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Autorizimi

1. Shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje i nënshtrohen autorizimit.
2. Autorizimet lëshohen në emër të sipërmarrjes transportuese. Ato nuk mund të jenë të transferueshme nga ky i dyti te palët e treta. Megjithatë, transportuesi i cili ka marrë autorizim mund të kryejë një shërbim nëpërmjet një nënkontraktori.
3. Periudha e vlefshmërisë së një autorizimi nuk i kalon tre vjet për shërbimet e rregullta dhe një vit për shërbimet vajtje-ardhje.
4. Autorizimi specifikon sa më poshtë vijon:
 - a) llojin e shërbimeve;
 - b) itinerarin e shërbimit, duke dhënë në veçanti vendin e nisjes, vendin e destinacionit, si dhe pikat e kalimit kufitar;
 - c) periudhën e vlefshmërisë së autorizimit;
 - d) për shënimet e rregullta, ndalesat dhe oraret.
5. Kërkesat për autorizim i dorëzohen autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese ku mjeti është i regjistruar, i cili mund ta pranojë ose jo atë. Në rastin kur kërkesa pranohet, autoriteti i mësipërm i komunikon autorizimin autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese. Nëse kjo e fundit bie dakord, atëherë çdo autoritet kompetent lëshon autorizimin për atë pjesë të itinerarit që kryhet në territorin e tij.
6. Kërkesa në dy kopje duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga legjislacioni kombëtar, gjithashtu edhe skicën e linjës që përmban të shënuar mirë stacionet e autobusit dhe kilometrat. Autoritetet kompetente lejohen t'u kërkojnë transportueseve për të dhënë çdo të dhënë të përshtatshme që mund të konsiderohet e nevojshme.
7. Gjatë udhëtimit një kopje e autorizimit të lëshuar nga autoritetet kompetente ose origjinali i tij duhet të mbahet në bord të mjetit.
8. Forma e autorizimit vendoset nga komiteti drejtues.

Neni 8

Përfshirja nga autorizimi

Transiti përmes territorit të njëres prej Palëve Kontraktuese në shërbimet e rastit, të kryer nga një mjet i regjistruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përfshihet nga çdo lloj autorizimi.

Neni 9

Shkëmbimi i dokumentacionit

Një shërbim i rregullt miratohet dhe mund të fillojë operacionin menjëherë, pasi autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese kanë shkëmbyer autorizimin e posaçëm me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 10

Dorëzimi i të dhënave

Gjatë tre muajve të parë të çdo viti kalendarik, transportuesit që operojnë në shërbimet e rregullta u dërgojnë autoriteteve kompetente të vendeve të tyre të dhënat e mëposhtme të vitit të kaluar:

- a) numrin e udhëtimeve dhe kilometrat;
- b) numrin e udhëtarëve.

Të dhënat e mësipërme duhet të shkëmbehen ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve kontraktuese.

II. Transporti i mallrave

Neni 11

Regjimi i licencimit

1. Transportuesit e vendosur në territorin e një Pale Kontraktuese lejohen të kryejnë transport ndërkombëtar rrugor të mallrave me qira ose shpërblim ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese (transporti dypalësh), gjithashtu edhe përmes tyre drejt vendeve të tjera (transporti transit), duke përdorur një leje të lëshuar nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

2. Nuk do të ketë kufizime në lidhje me numrin e lejeve të siguruara sipas paragrafit 1 të këtij neni. Megjithatë, komiteti i përbashkët i krijuar në bazë të nenit 15, mund të vendosë të kryejë transportin e mallrave, siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni, pa leje.

3. Në lidhje me transportin rrugor të mallrave, i kryer nga transportues të një Pale Kontraktuese, që niset nga territori i Palës tjetër Kontraktuese dhe i lidhur për një vend të tretë (transporti trekëndor), lëshohet një leje e veçantë nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese prej të cilës ose te e cila kryhet transporti. Këto leje të veçanta mund të përdoren vetëm nga transportuesit, në emrin e të cilëve ato ishin lëshuar dhe nuk janë të transferueshme. Mundësia e lëshimit të lejeve të këtij lloji, si dhe numri i tyre përcaktohen nga komiteti i përbashkët.

Neni 12 Lloji i lejeve

Lloji i lejeve të përmendura në nenin 11 përcaktohet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bazë të përfundimeve të miratuara nga komiteti i përbashkët.

Neni 13 Shkëmbimi i lejeve

1. Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese shkëmbejnë çdo vit lejet e kërkuara përmes kanaleve diplomatike ose përmes procedurës që do të vendoset nga komiteti i përbashkët.

2. Gjatë periudhës së parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, domethënë para mbledhjes së parë të komitetit të përbashkët, Palët Kontraktuese bien dakord të plotësojnë nevojat në lidhje me transportin rrugor bilateral dhe transit të mallrave, ndërsa kjo duhet t'u njoftohet autoriteteve të tyre kompetente përkatëse përmes kanaleve diplomatike.

Neni 14 Përjashtimi nga lejet

Pavarësisht nga neni 11, nuk kërkohen leje për rastet e mëposhtme:

1. Transporti i objekteve nga/ose te një aeroport publik në rast të fatkeqësive ose të ndonjë aksidenti tjetër të aeroplanit, ose në qoftë se aeroplani duhet të ulet për shkak të ndryshimit të rrugës ose emergjencës dhe në rastin kur fluturimet anulohen.

2. Transporti i mjetit të dëmtuar dhe trailerit të tij;

3. Transporti funeral;

4. Transporti i sendeve personale në kontekstin e transferimit të plaçkave shtëpiake me mjete të veçanta;

5. Transporti i postës;

6. Transporti i mallrave për panaire dhe ekspozita;

7. Transporti i aksesorëve dhe mallrave të tjerë për shfaqje teatrale, muzikore dhe ngjarje të tjera kulturore, shfaqje cirku dhe filma dhe koncertet në radio ose televizion;

8. Transporti i kafshëve të ngordhura, përveç rastit të përdorimit të tyre industrial si lëndë e parë;

9. Transporti i bletëve ose rasteve të peshkut;

10. Transporti i mallrave me mjete, peshë e lejuar e ngarkesës së të cilëve, përfshirë atë të trajlerave, nuk i kalon 6 ton, ose ngarkesa e lejuar e të cilëve, përfshirë atë të trajlerave, nuk i kalon 3.5 ton;

11. Transporti i substancave farmaceutike ose çdo material tjetër ndihmës në rast të katastrofave të shkaktuara nga fenomenet natyrore;

12. Transporti i mjeteve bosh për zëvendësimin e mjeteve të dëmtuara të cilat marrin përsipër transportin e mallrave që ato të dëmtuarat nuk mund të kryejnë;

13. Transporti me trailer në një grup mjedesh të përbëra nga mjete që i përkasin transportuesit vendas dhe një trajler i huaj;

14. Mjete që u japin ndihmë teknike ose të riparimit mjeteve të dëmtuara (mjete shërbimi dhe riparimi);

15. Transporti i një mjeti i cili duhet të zëvendësojë një tjetër mjet të dëmtuar që ndodhet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

16. Transporti i ngarkesës që përdoret për edukim dhe reklama.

Në lidhje me operacionet e transportit të përmendura në këtë nen, drejtuesi i mjetit duhet të mbajë në bord të gjitha letrat dhe dokumentet që tregojnë qartë se është rasti i një nga llojeve të transporteve të mësipërm.

III. Dispozita të përgjithshme

Neni 15

Komiteti i përbashkët

1. Me qëllim rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë lidhje me zbatimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, krijohet një komitet i përbashkët. Ky Komitet përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, të cilët mund të ftojnë në mbledhje përfaqësuesit e industrisë së transportit rrugor.

2. Komiteti i përbashkët mblidhet me kërkesën e cilësdo Palë Kontraktuese, në mënyrë alternative në territorin e cilësdo Palë Kontraktuese. Axhenda e takimit paraqitet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese pritëse ose kërkuese e takimit, të paktën dy javë më parë. Secili takim përfundon me miratimin e një Protokolli të nënshkruar nga kryetarët e delegacioneve të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

3. Komiteti i përbashkët vendos gjithashtu për cakun kohor, si edhe për mënyrën e shkëmbimit të të dhënave dhe të gjithë informacinit tjetër përkatës.

Neni 16

Taksimi

1. Palët Kontraktuese bien dakord që mjetet e regjistruara në territorin e cilësdo Palë Kontraktuese përjashtohen nga të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e vendosura për qarkullimin ose pronësinë e mjeteve në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Përjashtimet sipas këtij neni nuk aplikohen për taksat rrugore dhe tatimet e vlerës së shtuar as për detyrimet doganore dhe të aksizës mbi konsumin e karburantit të mjeteve, përveç karburantit që ndodhet në serbatorin e zakonshëm të karburantit të mjeteve që hyjnë.

Neni 17

Legjislacioni kombëtar

1. Transportuesit e një Palë Kontraktuese dhe ekuipazhet e mjeteve të tyre, kur hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në atë vend.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare të pranura nga të dyja Palët Kontraktuese dhe anëtarësimi i tyre në organizatat ndërkombëtare, veçanërisht në organizatat e integritit ekonomik rajonal.

Neni 18

Sigurimi

Mjetet e Palëve Kontraktuese që kryejnë transporte ndërkombëtare rrugore të udhëtarëve dhe/ose të mallrave duhet të kenë mbulim sigurimi si për vendet në transit, dhe vendin e destinacionit.

Neni 19
Kabotazhi

Ndalohej kryerja e shërbimeve të kabotazhit në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.

Neni 20
Doganat dhe kontrolli shëndetësor

Dispozitat e konventave ndërkombëtare të miratuara nga Palët Kontraktuese janë të zbatueshme për kontrollin doganor dhe shëndetësor në pikat e kalimeve kufitare transite. Kontrolli në fjalë kryhet, nëse është e mundur, me prioritet në rastin e transportit të pacientëve, kafshëve dhe mallrave që prishen shpejt.

Neni 21
Kontrolli teknik i mjeteve

1. Cilido mjet i një Pale Kontraktuese që kryen transport bilateral ose transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të pajiset me një certifikatë të vlefshme të inspektimit teknik rrugor të lëshuar nga autoriteti i përshtatshëm i vendit të tij. Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese, në territorin e të cilës kryhet operacioni i transportit, mund të kërkojnë kryerjen e kontrollit teknik për mjetet e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Cilido mjet i Palës tjetër Kontraktuese që kryen transport bilateral ose transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe që transporton mallra të rrezikshme, duhet të mbajë në bord të gjitha dokumentet e parashikuara nga Konventa e ADR-së.

Neni 22
Hyrja në fuqi, vlefshmëria, denoncimi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit që vërteton përmbushjen e kërkesave kushtetuese respektive të Palëve Kontraktuese për miratimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të qëndrojë në fuqi për një vit. Kjo Marrëveshje pas kësaj zgjatet në mënyrë të heshtur për periudha të mëtejshme njëvjeçare, vetëm nëse njëra nga Palët Kontraktuese njofton tjetrën për qëllimin e saj për të denoncuar atë. Denoncimi ka efekt gjashtë muaj pas datës kur merret një njoftim i tillë.

Neni 23
Ndryshimet

Për çdo ndryshim ndaj kësaj Marrëveshjeje bihet dakord me shkrim ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe hyn në fuqi në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 22.

Bërë në Tiranë më 6.6.2008, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, greke dhe angleze, të gjitha tekstet duke qenë njëloj autentike.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

LIGJ
Nr.9982, datë 8.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9461, DATË 21.12.2005 “PËR

**NOMENKLATURËN E MALLRAVE DHE TARIFËN DOGANORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “Nomenklatura e mallrave” zëvendësohen me fjalët “Nomenklatura e kombinuar e mallrave (NK)”.

Neni 2

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1

Në rastet e bashkimeve të kodeve të nomenklaturës së kombinuar të mallrave me nivele të ndryshme tarifore zbatohet, në çdo rast, niveli më i ulët tarifor, me përjashtim të rasteve kur, me ligj të veçantë, parashikohet ndryshe.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5886, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

**LIGJ
Nr.9983, datë 8.9.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8934, DATË 5.9.2002 “PËR
MBROJTJEN E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38

Afatet e shqyrtimit të kërkesave për miratim mjedisor

1. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, autorizimi mjedisor dhe pëlqimi mjedisor shqyrtohen dhe miratohen brenda afateve të mëposhtme:

- a) deklarata mjedisore, brenda 3 javëve nga paraqitja e kërkesës;
- b) leja mjedisore, brenda 5 javëve nga paraqitja e kërkesës;
- c) autorizimi dhe pëlqimi mjedisor, brenda 2 javëve nga paraqitja e kërkesës.

2. Koha për plotësimin e dokumentacionit, sipas kërkesave të nenit 37 të ligjit në fuqi, nuk llogaritet në afatet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni.

3. Nëse kërkuesi nuk i përgjigjet, brenda tre muajve, kërkesës me shkrim të organit miratues, për plotësim apo përmirësim dokumentesh, vlerësohet se është hequr dorë nga kërkesa për miratim mjedisor.

4. Kur është e nevojshme kryerja e ekspertizave të kualifikuara, organi përgjegjës, me vendim të arsyetuar, mund ta zgjasë kohën e dhënies së secilit dokument, deri në dyfishin e kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Nëse organi miratues nuk përgjigjet brenda afateve të mësipërme, secili dokument quhet i miratuar dhe kërkuesi mund ta vazhdojë veprimtarinë. Ndërkohë organi miratues njofton kërkuenin për kushtet dhe kërkesat e dokumentit të miratimit.

6. Secili dokument i përmendur në pikën 1 të këtij neni është i vlefshëm nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe për sa kohë që kushtet, në bazë të të cilave është miratuar dokumenti, nuk ndryshojnë.”.

Neni 2

Në nenin 83 pika 1 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) për shkronjat “g”, “h”, “j” e “k, nga 300 000 deri në 500 000 lekë;”.

2. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) për shkronjën “g”, ku trajtohet ushtrimi pa leje mjedisore i veprimtarive që ndotin e dëmtojnë mjedisin, nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5887, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9984, datë 11.9.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KOMUNITETIT “PROGRAMI I
VEÇANTË PËR SIPËRMARRJEN DHE NOVACIONIN (EIP) TË PROGRAMIT KUADËR
TË KONKURRUESHMËRISË DHE NOVACIONIT, 2007-2013””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e komunitetit “Programi i veçantë për sipërmarrjen dhe novacionin (EIP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit, 2007-2013””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5888, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KOMUNITETIT
“PROGRAMI I VEÇANTË PËR SIPËRMARRJEN DHE NOVACIONIN (EIP) TË PROGRAMIT
KUADËR TË KONKURRUESHMËRISË DHE NOVACIONIN (2007 DERI MË 2013)”

Komisioni i komuniteteve europiane, këtu i referuar “Komisioni”, në emër të Komunitetit Europian, nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, këtu e referuar Shqipëria, nga ana tjetër, ndërsa:

1. Marrëveshja kuadër ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në Programet e Komunitetit që u

nënshkrua më 22 nëntor 2004, dhe hyri në fuqi më 22 gusht 2005¹ (këtu të referuar: Marrëveshja kuadër) përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit, duke i lënë Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë të përcaktojë termat dhe kushtet e veçanta, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me këtë pjesëmarrje në secilin program të veçantë;

2. Në pajtim me nenin 1 (2) të Marrëveshjes kuadër, Shqipëria lejohet të marrë pjesë në programet e Komunitetit të përcaktuara ose rinovuara pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe që përmban një dispozitë hyrëse që parashikon pjesëmarrjen e Shqipërisë;

3. Programi kuadër i konkurrueshmërisë dhe novacionit u vendos me vendimin Nr 1639/2006/EC të Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 24 tetor 2006²;

4. Në pajtim me nenin 4 (c) të vendimit 1639/2006/EC, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të marrin pjesë në program në pajtim me dispozitat që vendosen me ato vende pas arritjes së Marrëveshjeve Kuadër në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në programet e Komunitetit, kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1 Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në “Programin e veçantë të sipërmarrjes dhe novacionit (EIP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit (CIP)”, (këtu referuar si “Programi”), në pajtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër të lidhur në emër të Komunitetit më 2 qershor 2005 ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit, dhe sipas termave dhe kushteve të përmendura në këtë memorandum mirëkuptimi.

Neni 2 Termet dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e programit në pajtim me objektivat, kriteret dhe procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr.1639/2006/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 24 tetor 2006 sipas kushteve të mëposhtme:

- që nga viti 2008, pjesëmarrja do të jetë e hapur për masat e mëposhtme të programit:
- projekte pilot dhe të riprodhimit në treg të novacionit dhe ekonovacionit;
- analiza e politikave, zhvillimi, bashkërendimi dhe binjakëzimi.

Nëse Komisioni do të lançojë gjatë programit një ftesë të tretë për pjesëmarrje në rrjetin e ndërmarrjeve në Europë (EEN), Shqipëria do të lejohet të marrë pjesë në atë pjesë të programit.

2. Termet dhe kushtet e zbatueshme për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave nga institucionet, organizatat dhe individët e përshtatshëm në Shqipëri do të jenë të njëjta me ato që zbatohen për institucionet, organizatat dhe individët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

3. Për të marrë pjesë në program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian në pajtim me nenin 3 të mëposhtëm. Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e programit do t'i shtohet alokimi vjetor në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian për detyrimin përkatës të caktuar për të përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për realizimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

4. Për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspektet e tjera administrative të programit do të përdoret një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit.

¹ GZ L 192, 22.7.2005, f. 1, 2, 78

² GZ L 310, 9.11.2006, f. 15

Neni 3
Kontributi financiar

Rregullat që rregullojnë kontributet financiare të Shqipërisë janë të përcaktuara në aneksin I.
Pjesë e atij kontributi financiar mund të financohet nga instrumenti përkatës i ndihmës së huaj të Komunitetit, nëse këtë e kërkon Shqipëria³.

Neni 4
Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatave të Auditorëve të Komuniteteve Europiane në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria i paraqet Komisionit raporte përkatëse dhe merr pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga Komuniteti në këtë kontekst.

Në pajtim me rregulloret e Këshillit (EC, Euratom) Nr.1605/2002 të datës 25 qershor 2002 mbi rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane⁴ dhe rregulloren e Komisionit (EC, Euratom) Nr. 2342/2002 që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e rregullores së Këshillit Nr 1605/2002⁵ të datës 23 dhjetor 2002 dhe me rregullat e tjera që i referohen këtij memorandum mirëkuptimi, kontratat e lidhura me përfituesit e programit të vendosur në Shqipëri parashikojnë auditime financiare dhe të tjera, mbi bazën e dokumenteve dhe në terren, që duhet të kryhen në çdo kohë nga agjentët e Komisionit, ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë të drejtën e hyrjes së përshtatshme në dokumente dhe tek i gjithë informacioni i kërkuar për të kryer këto auditime, duke përfshirë formatin elektronik. Kjo e drejtë hyrjeje parashikohet shprehimisht në kontratat e lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Memorandum. Gjykata Europiane e Auditorëve ka të njëjtat të drejta si dhe Komisioni.

Neni 5
Dispozita të fundit

Ky memorandum mirëkuptimi zbatohet për kohëzgjatjen e programit. Megjithatë, nëse Komuniteti European vendos për të zgatur afatin pa ndonjë ndryshim thelbësor në program, ky memorandum do të zgjatet përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjë prej Palëve nuk e denoncon atë brenda një muaji nga vendimi për zgjatjen e afatit.

Projektet dhe aktivitetet e papërfunduara në momentin e pushimit të fuqisë do të vazhdojnë deri në përmbushjen e tyre sipas kushteve të parashikuara në këtë memorandum mirëkuptimi, si dhe masave kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitat e aneksit II.

Anekset janë pjesë integrale e këtij memorandum mirëkuptimi.

Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e përbashkët të Palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike me anë të të cilit Republika e Shqipërisë njofton Komisionin që janë përmbushur kërkesat ligjore të brendshme për hyrjen e tij në fuqi.

Bërë në më Bërë në më

Për Republikën e Shqipërisë:
Z. Genc Ruli
Minisër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Për Komisionin:
në emër të Komunitetit European
Z Günter Verheugen

³ Shuma e plotë e asistencës nga ndihma e huaj e Komunitetit do të tregohet në Memorandumin e Financimit në Programin Kombëtar vjetor në lidhje me këtë asistencë (fonde të veçanta të para-aderimit)

⁴ GZ L 248, 16.9.2002, f. 1. Rregullore e ndryshuar së fundi me Rregulloren (EC, Euratom) Nr 1995/2006 (GZ L 390, 30.12.2006, f. 1.)

⁵ GZ L 357, 31.12.2002, f. 1 Rregullore e ndryshuar së fundi me Rregulloren (EC, Euratom) Nr 478/2007 (GZ L 111, 28.04.2007, f. 13.)

RREGULLAT

QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E VEÇANTË PËR SIPËRMARRJEN DHE NOVACIONIN (EIP) TË PROGRAMIT KUADËR TË KONKURRUESHMËRISË DHE NOVACIONIN (CIP)

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian për të marrë pjesë në EIP përcaktohet çdo vit në raport me dhe si shtesë e caktimit vjetor në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian për detyrimin përkatës të caktuar të pjesëve që nevojitet për zbatimin, menaxhimin dhe operimin e EIP-së.

2. Faktori i proporcionalitetit që rregullon kontributin e Shqipërisë do të arrihet nëpërmjet vendosjes së një raporti ndërmjet prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë me çmimet e tregut dhe shumës së produkteve të brendshme bruto me çmimet e tregut në të njëjtin vit, të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian dhe Shqipërisë:

$$(\text{GDP me çmimet e tregut për Shqipërinë}) / (\text{GDP me çmimet e tregut për BE-në 27 + Shqipërinë}) = \text{faktori i proporcionalitetit}$$

$$(\text{faktori i proporcionalitetit}) \times (\text{alkimi vjetor për EIP-në në buxhetin e përgjithshëm të BE-së}) = \text{kontributi vjetor i Shqipërisë në EIP.}$$

Ky raport llogaritet mbi bazën e të dhënave të fundit statistikore që i takojnë të njëjtit vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Europiane (EUROSTAT), që ofrohet në momentin e publikimit të projektbuxhetit paraprak të Bashkimit Europian.

3. “Programi i veçantë për sipërmarrjen dhe novacionin (EIP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit (2007 deri 2013)” lejon mënyrën “à la carte”, d.m.th. është e mundur për Shqipërinë të zgjedhë sferat EIP në të cilat do të marrë pjesë. Kontributi financiar duhet të paguhet vetëm për ato fusha.

4. Fushat në të cilat Shqipëria merr pjesë janë ato të përcaktuara në nenet 21-23 të vendimit nr 1639/2006/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 24 tetor 2006:

- projekte pilot dhe të riprodhimit në treg të novacionit dhe ekonovacionit;
- analiza e politikave, zhvillimi, bashkërendimi dhe binjakëzimi.

5. Këto sfera përputhen me pjesët e mëposhtme të buxhetit të EIP-së:

Projekte pilot dhe të riprodhimit në treg të novacionit dhe ekonovacionit	25 %
Analiza e politikave, zhvillimi, bashkërendimi dhe binjakëzimi	6 %
	31%

6. Shqipëria merr pjesë në 31% të EIP-së. Nëse Shqipëria aplikon suksesshëm për një ftesë e mundshme për pjesëmarrje në Rrjetin e Ndërmarrjeve në Europë të lançuar gjatë programit (që përputhet me 17% të buxhetit të EIP-së), Shqipëria do të marrë pjesë në 48% të programit gjatë viteve në të cilat projekti shqiptar merr grandin në bazë të kësaj ftese.

Që nga viti 2008, kontributi i saj financiar llogaritet si më poshtë:

$$\text{Buxheti EIP për vitin (n)} \times (\% \text{ të EIP-së në të cilin Shqipëria merr pjesë}) \times \text{faktorin e proporcionalitetit të Shqipërisë} = \text{kontributi vjetor i Shqipërisë për në EIP.}$$

7. Do të zbatohet një normë me faza:

- 70% në 2008
- 75% në 2009
- 80% në 2010
- 85% në 2011
- 90% në 2012
- 95% në 2013

8. Kontributi i Shqipërisë do të zbatohet si më poshtë për çdo vit financiar:
- kontributi sipas faktorit të proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, të shumëzuar me përqindjen e buxhetit të EIP-së për vitin në të cilin Shqipëria merr pjesë, në pajtim me paragrafin 6, të shumëzuar me normën sipas fazave në pajtim me paragrafin 7.

9. Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian për të marrë pjesë në dy komponentët e programit janë si më poshtë:

EUR 36,738 për 2008

10. Bazuar në këtë metodë financiare dhe mbi një supozim të rritjes vjetore të GDP-së prej 2,3% për BE-në dhe 6.0% për Shqipërinë, kjo çon në kontributet vjetore treguese të mëposhtme:

EUR 42.124 për 2009

EUR 48.561 për 2010

EUR 58.348 për 2011

EUR 64.533 për 2012

EUR 73.102 për 2013

11. Komisioni i komunikon Shqipërisë, sa më parë të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij memorandum mirëkuptimi, informacionin e mëposhtëm së bashku me materialin paraprak përkatës:

- shumat e detyrimit përkatës të caktuar në deklarin e shpenzimeve të projektbuxhetit paraprak të Komuniteteve Europiane që i takojnë EIP-së;

- shumën e parashikuar të kontributeve që rrjedhin nga projektbuxheti paraprak, që i takon pjesëmarrjes së Shqipërisë në EIP, në pajtim me paragrafët 1 deri 8.

12. Sapo të jetë miratuar buxheti i përgjithshëm, Komisioni i komunikon Shqipërisë, në një deklarin të shpenzimeve që i takojnë pjesëmarrjes së Shqipërisë, shumat përfundimtare që përmenden në nënparagrafin e parë.

13. Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë shpenzimet në lidhje me përgatitjen, zhvillimin dhe realizimin e projekteve të parashikuara në program.

14. Shpenzimet e udhëtimit dhe ditore, të shkaktuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimet e marrjes pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 46.1(a) të vendimit Nr 1639/2006/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 24 tetor 2006 që vendos Programin Kuadër të Konkureshmërisë dhe Novacionit (Komiteti Menaxherial i EIP-së), ose takime të tjera në lidhje me zbatimin e programit rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në pajtim me procedurat tashmë në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

15. Rregullorja financiare e zbatueshme në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Me hyrjen në fuqi të këtij memorandum mirëkuptimi, dhe në fillim të çdo viti pasues financiar, Komisioni i dërgon Shqipërisë një ftesë për fonde të shprehur në euro, që përputhet me kontributin e saj në shpenzimet e mbuluara nga ky memorandum mirëkuptimi.

2. Ky kontribut paguhet në euro në një llogari bankare në euro të Komisionit.

3. Shqipëria e paguan kontributin e saj financiar për shpenzimet vjetore në pajtim me ftesën për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së ftesës. Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria për shumën e prapambetur nga data e kërkuar për t'u paguar. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Europiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, që publikohet në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Europian, në fuqi që nga dita e parë kalendarike e muajit në të cilin bie data e kërkuar për t'u paguar, e rritur me 3.5 pikë përqindjeje.

Nëse vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e efektshëm të të gjithë ose një pjese të programit, dhe në mungesë të pagesës në 20 ditë pune pas letrës formale të kujtesës të dërguar Shqipërisë nga Komisioni, pjesëmarrja e Shqipërisë në program për vitin përkatës do të pezullohet, pa cenuar detyrimin e Komunitetit në pajtim me kontratat tashmë të lidhura.

Aneksi II

Kontrolli financiar, rikuperimi dhe masat e tjera kundër mashtrimit

I. Kontrolli dhe masat e Komunitetit kundër mashtrimit

1. Në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë memorandum mirëkuptimi,

kontratat e lidhura me përfituesit e programit të vendosur në Shqipëri parashikojnë auditime financiare dhe të tjera që kryhen në çdo kohë në ambientet e përfituesve dhe nënkontraktorëve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë të drejtën e hyrjes së përshtatshme në kantiere, vende pune, dokumente dhe tek i gjithë informacioni i kërkuar për të kryer këto auditime, duke përfshirë formatin elektronik. Kjo e drejtë hyrjeje parashikohet shprehimisht në kontratat e lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë memorandum. Gjykata Europiane e Auditorëve ka të njëjtat të drejta si dhe Komisioni.

3. Në kuadrin e këtij memorandum, Komisioni/OLAF (Zyra Europiane Kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrolle në terren si dhe inspektime në territorin e Shqipërisë, në pajtim me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom, EC) Nr 2185/96 të datës 11 nëntor 1996.

4. Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë të caktuara nga autoritetet e Shqipërisë, që mund të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të japin të gjithë ndihmën e duhur.

5. Nëse autoritetet e interesuara të Shqipërisë dëshirojnë, kontrollet dhe inspektimet në terren mund të kryhen bashkërisht me to:

- nëse pjesëmarrësit në program kundërshtojnë kontrollin dhe inspektimin në terren, autoritetet e Shqipërisë, që veprojnë në pajtim me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF atë ndihmë që atyre u duhet për t'u mundësuar të përmbushin detyrat e tyre për kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në terren.

- Komisioni/OLAF raporton sa më shpejt të jetë e mundur tek autoritetet e Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që ka dalë në dukje gjatë kontrollit ose inspektimit në terren. Në çdo rast Komisionit/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur në lidhje me rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Për qëllimin e zbatimit të përshtatshëm të këtij aneksi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe autoritetet e Komunitetit shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të një prej Palëve, zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë informojnë Komisionin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që ka tërhequr në vëmendjen e tyre në lidhje me lidhje me një parregullsi në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë memorandum.

III. Masat administrative dhe gjobot

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal në Shqipëri, masat administrative dhe gjobot mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian.

IV. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda kuadrit të këtij memorandum, që caktojnë një detyrim financiar mbi personat e ndryshëm nga shtetet, janë të ekzekutueshme në Shqipëri. Ekzekutimi rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit ai zbatohet. Urdhri i ekzekutimit i bashkëngjitet vendimit, pa formalitet tjetër përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti i brendshëm që cakton Qeveria e Shqipërisë për këtë qëllim dhe ia bën të ditur Komisionit. Pasi të jenë përfunduar këto formalitete me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në pajtim me ligjin e brendshëm, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Europiane.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane, në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë brenda kuadrit të këtij memorandum, janë të ekzekutueshme me të njëjtat kushte.

LIGJ

Nr.9985, datë 11.9.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7952, DATË 21.6.1995 “PËR SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “arsim i detyruar” zëvendësohen me fjalët “arsim bazë”.

Neni 2

Kudo në ligj fjalët “shkollat e mesme të përgjithshme” zëvendësohen me fjalën “gjimnaze”.

Neni 3

Në nenin 8, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeçare në Republikën e Shqipërisë duhet të fillojnë arsimin bazë, i cili zgjat jo më pak se 9 vjet.”.

Neni 4

Në nenin 20, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Arsimi bazë është arsimi i detyruar dhe i njësuar.”.

Neni 5

Në nenin 30 pika 30.1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Afati i këtyre shkollave është 3 vjet.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5889, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9986, datë 11.9.2008

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE DOGANORE DHE TATIMORE, TË DETYRIMEVE TË
PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË MJETEVE E
TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE, SI DHE TË GJOBAVE
E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË
DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I FALJA E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DOGANORE

Neni 1

Personave fizikë e juridikë, që janë debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, të evidentuar dhe të kontabilizuar pa vendime administrative përkatëse apo me vendime administrative të panjoftuara brenda afateve ligjore, të parashikuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin për procedurat tatimore, u falet detyrimi doganor dhe tatimor, së bashku me komponentët, gjobat dhe kamatëvonesat.

Neni 2

Personave fizikë e juridikë, debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, që janë aktualisht të evidentuar dhe të kontabilizuar si të tillë në këto dy administrata, për të cilët procedura e evidentimit, marrjes së vendimit administrativ përkatës, si dhe njoftimit të tij debitorit është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit për procedurat tatimore, u falen gjobat dhe kamatëvonesat, me kusht që principlali i detyrimit të paguhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 3

1. Personave fizikë, individë, debitorë ndaj administratës doganore, për automjetet e importuara, të evidentuara dhe të kontabilizuara deri në datën 31.12.2000, u falet detyrimi doganor, me të gjithë komponentët e tij, si kamatëvonesa, gjoba dhe ditë-qëndrimi.

2. Personave fizikë e juridikë, debitorë ndaj administratës doganore, për automjetet e importuara, të evidentuara dhe të kontabilizuara nga data 1.1.2001 deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, u falen kamatëvonesat, gjobat dhe taksa për ditë-qëndrimi, me kusht që principlali i detyrimit të arkëtohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve e shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, u falen detyrimi doganor dhe detyrimi tatimor, me të gjithë komponentët, si kamatëvonesa dhe gjoba.

KREU II FALJA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË MJETEVE DHE TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE

Neni 5

Taksapaguesve të mjeteve rrugore, debitorë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe debitorë ndaj njërive të qeverisjes vendore, për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, u falen detyrimet e prapambetura me kusht që:

pronarët e mjeteve, që nuk janë në qarkullim, të kenë kryer, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, veprimet përkatëse të çregjistrimit, sipas nenit 102 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

pronarët e mjeteve, që janë në qarkullim, të kenë kryer, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, veprimet përkatëse të pagesës së detyrimeve, me të gjithë komponentët, për vitin 2008, sipas ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9632, datë 15.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

KREU III

FALJA E GJOBAVE DHE KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Neni 6

1. Ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, institucioneve shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, ndërmarrjeve e shoqërive me kapital të përbashkët me shtetin, personave juridikë e fizikë privatë u falen gjobat dhe kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që principi i kontributit të paguhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Personave fizikë të vetëpunësuar, të cilët e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike përpara datës 31.12.2005 dhe që janë debitorë, të evidentuar dhe të kontabilizuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, u falen të gjitha detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat.

3. Personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen gjobat dhe kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që principalin e kontributit ta paguajnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU IV

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 7

Individët, personat fizikë dhe juridikë, debitorë ndaj administratës doganore e tatimore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të cilët ka filluar një procedim penal dhe që në përfundim të tij deklarohen fajtorë, apo detyrimi i të cilëve është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose që e kanë paguar detyrimin, me të gjithë komponentët e tij, nuk janë përfitues të faljes së detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 8

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore për kontabilizimin e të ardhurave, të mbledhura në përputhje me nenet 2, 3, 4 e 6 të këtij ligji dhe për sistemimin e detyrimeve të papaguara të subjekteve debitoare në një llogari kontabël “Detyrimi i keq”.

Neni 9

1. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemimin e detyrimeve të prapambetura, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5890, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM
Nr.211, datë 11.9.2008

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të nenit 33 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Flora Çabej (Pogaçe) zgjidhet në detyrën e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.212, datë 15.9.2008

PËR SHKARKIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT, ZOTIT FRANO KULLI

Në bazë të nenit 78 të Kushtetutës dhe në mbështetje të neneve 14 pika 1 e 15 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Frano Kulli shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.9.2008
Doli nga shtypi më 22.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë